

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani, kryetari i kolegjit, Shqipe Qerimi dhe Gani Zabeli anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hysni Ismaili, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.I. nga fshati ..., komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par. 5 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjiilan dhe ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit H.I., av.S.M. të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjiilan-Dega në Viti, P.nr.283/2016, të datës 21.06.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), me datë 21.11.2016, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**Refuzohen** si të pa bazuara ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjiilan dhe ajo e mbrojtësit të të akuzuarit H.I., av.S.M. kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjiilan-Dega në Viti, P.nr.283/2016, të datës 21.06.2016, **vërtetohet**.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjiilan-Dega në Viti, me aktgjykimin P.nr.283/2016, të datës 21.06.2016, të akuzuarin H.I. e ka shpallur fajtor për shkak se ka kryer veprën penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par. 5 lidhur me par.1 të KPRK-së, për të cilën e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e qëndrimit në arrest shtëpiak prej datës 27.09.2015 deri më 20.10.2015 e të cilin dënim duhet ta vuajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Me pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, gjykata e shkallës së parë konform nenit 47 të KPRK, dënimin e shqiptuar me burg e ka zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 3000€ (tre mijë), të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në dënimin me gjobë, të akuzuarit do ti llogaritet edhe koha e qëndrimit në arrest shtëpiak prej datës 27.09.2015 deri më 20.10.2015, duke u llogaritur për çdo ditë të kaluar në arrest shtëpiak nga 20€. Nëse i akuzuari në tërësi nuk e paguan dënimin e shqiptuar me gjobë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, atëherë dënimi me burg do të ekzekutohet. Është refuzuar kërkesa për konfiskimin e automjetit të markës "Land Rover" me tabela të regjistrimit .... dhe leja e qarkullimit .... Të dëmtuarit R.Xh., N.J. dhe S.M., që

të gjithë zyrtarë policorë në ..., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil. Është obliguar i akuzuari të paguaj shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 0 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë kanë ushtruar:

- Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe atë vetëm për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit t'i shqiptoj dënim më të ashpër. Në këtë ankesë, përgjegje ka parashtruar i akuzuari H.I. me propozim që Gjykata e Apelit të refuzojë si të pa bazuar ankesën e Prokurorit ndërsa të vërtetojë aktgjykimin e ankimuar.

- Mbrojtësi i të akuzuarit H.I., av. S.M. vetëm për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit t'i shqiptoj dënim më të butë.

Gjykata e Apelit konform dispozitave të nenit 390 të KPPK-së, mbajti seancën e kolegjit për të cilën me kohë dhe në mënyrë të rregullt i njoftoj palët. Në seancë, edhe pse të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt, nuk prezantoi askush.

Prokurori i Apelit me parashtresën, PPA/II.nr.1278/2016, të datës 13.10.2016, ka propozuar që ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i ashpër, ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuarit dhe propozimi i të akuzuarit nga përgjigja në ankesën e Prokurorit, të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, duke vlerësuar pretendimet ankimore në ankesa, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

### **Ankesat nuk janë të bazuara.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithat Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par.2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimin të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Sa i përket vendimit për dënim, Prokurori me ankesë pretendon se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë nuk është adekuat me shkallën e përgjegjësisë penale të

të akuzuarit. Në ankesë theksohet se gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit i ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese, ndërsa nuk ka vlerësuar rrethanat rënduese se i akuzuari me veprimet e tija ka dëmtuar autoritetin dhe ka rrezikuar edhe jetën e zyrtarëve policorë pasi që i akuzuari i ka penguar personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare. Njëherit në ankesë është theksuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar si rrethana rënduese shkallën e përgjegjësisë penale, kryerjen e veprës penale me dashje dhe vetëdije të plotë si dhe veprimet tjera që paraqesin shqetësim në mospërfilljen ndaj zyrtarëve policorë. Sipas ankesës, dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nuk është në proporcion me peshën e veprës penale, rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me dënime të këtilla nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të akuzuarit. Bazuar në këto pretendime, Prokurori ka propozuar dënim më të ashpër.

Ndërsa, në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit, pretendohet se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar drejt rrethanat lehtësuese në këtë çështje si pranimin e fajësisë dhe mos ikjen e të akuzuarit nga përgjegjësia penale, faktin se i njëjti është i martuar, njeri familjar, se deri më tani nuk ka qenë në kundërshtim me ligjin, se i akuzuari nuk është i prirur për të kryer vepra penale dhe se incidenti ka ndodhur krejt rastësisht, pra në prani të këtyre rrethanave gjykata ka pasur mundësi ligjore që të mbrojturit të tij ti shqiptojë një dënim më të butë me çka do të arrihej qëllimi i dënimit.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e mësipërme ankimore të Prokurorit për një dënim më të ashpër, si dhe ato të mbrojtësit të akuzuarit për shqiptimin e një dënimi më të butë, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 74 të KPRK-së, me ç'rast si rrethana lehtësuese ka vlerësuar se i akuzuari është penduar dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, se është i martuar ndërsa si rrethana veçanërisht lehtësuese vlerësoi pranimin e fajësisë dhe faktin se deri më tani nuk ka qenë i dënuar ndërsa si rrethana rënduese ka marrë parasysh faktin se vepra është kryer ndaj zyrtarëve policorë dhe se veprat e këtij lloji janë të manifestuara me një numër të madh dhe paraqesin rrezikshmëri të përgjithshme shoqërore.

Vlerësimin e këtyre rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se në prani të këtyre rrethanave nuk ka vend për shqiptimin e një dënimi më të ashpër siç pretendon Prokurori apo dënim më të butë, siç pa të drejtë pretendohet në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit.

Rrethanat e pretenduara rënduese në ankesën e Prokurorit, pesha e veprës penale, rrezikshmëria shoqërore e veprës dhe shkalla e përgjegjësisë penale e të akuzuarit sipas vlerësimit të këtij Kolegji penale paraqesin elemente të veprës penale për kryerjen e së cilës i akuzuari është akuzuar dhe është shpallur fajtor dhe se të njëjtat nuk mund të vlerësohen si rrethana rënduese

Prandaj, me qenë se në ankesën e prokurorit nuk është theksuar ndonjë rrethanë e re rënduese që nuk ka qenë objekt vlerësimi i gjykatës dhe që kishte me ndikuar në shqiptimin e një dënimi më të ashpër, ndërsa rrethanat e pretenduara lehtësuese në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, kanë qenë objekt vlerësimi nga gjykata e shkallës së parë, pretendimet se gjykata është dashur të shqiptojë dënim më të ashpër respektivisht më të butë, janë të pabazuara. Pra, duke pasur parasysh se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar rrethanat

lehtësuese të theksuara në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit dhe në prani të këtyre rrethanave ka zbatuara dispozitën për zbutjen e dënimit, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit nga gjykata e shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar, kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e neni 401 të KPPK-së, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.1245/16 të datës 21.11.2016**

**Bashkëpunëtori profesional**

**Anëtarët e kolegjit**

**Kryetari i kolegjit**

**Hysni Ismaili**

**2. Shqipe Qerimi**

**1. Ferit Osmani**

**3. Gani Zabeli**